



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Nr.Prot. 1027

Tiranë, më 17.03 2021

Lënda: Mbi tentativën e mazhorancës dhe Bashkisë Tiranë për cenimin e veprimtarisë së një partie opozitare, pjesëmarrëse në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021.

Drejtuar: ZOTIT GRAMAZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

ZOTIT ILIRJAN CELIBASHI
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
ORGANEVE DREJTUESE TË KOMISIONIT QËNDROR TË
ZGJEDHJEVE

Për Dijeni: ZOTIT VINCENZO DEL MONACO
KRYETAR I PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI

ZOTIT LUIGI SORECA
AMBASADOR I DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

ZONJËS YURI KIM
AMBASADORE E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

AMBASADAVE TË VENDEVE ANËTARE TË BE-së, NË SHQIPËRI

Tiranë

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

Të nderuar Shkëlqesi Ambasadorë,

Siç dhe jeni njohur me zhvillimet e fundit, përmes medias së shkruar, elektronike dhe vizive, situata politike parazgjedhore dhe klima e besimit ndërmjet forcave politike garuese në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit, është cenuar rëndë.

Përpos faktit të pasqyrimin në media të zhvillimeve të fundit në Tiranë dhe Elbasan, si President i Republikës, më duhet t'ju bëj dije mbi një situatë tërësisht të paligjshme, që ndodhi në selinë e Frymës së Re Demokratike, forcë politike kjo e cila u sulmua dhunshëm nga strukturat dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë.

Ky sulm, që u organizua dhe ekzekutua vetëm pak ditë më parë, në datën 12 mars 2021, pas nënshkrimit të një marrëveshjeje të FRD-së me Partinë Demokratike dhe aleatët e saj për zgjedhjet e 25 prillit 2021, bie ndesh me të gjitha parimet demokratike të shtetit të së drejtës, bashkëjetesës që do të duhet të shoqërojë situatën, para, gjatë, dhe pas zgjedhore.

Ky sulm është një tjetër tregues i sjelljes tërësisht të papërgjegjshme dhe provokuese të mazhorancës, me qëllim dëmtimin e aktivitetit kushtetues dhe ligjor të kësaj force politike pjesëmarrëse në zgjedhje, por njëkohësisht edhe një dëshmi e përpjekjeve të saj sistematike për të minuar pluralizmin politik në vend.

Për dijeninë tuaj, ju rendis më poshtë të gjitha faktet, mbështetur nga dokumentet bashkëlidhur, e që evidentojnë qartë se si, të gjitha veprimet e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe administratës së tij, ndaj Frymës së Re Demokratike, janë kryer në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe ligjin, në shpërdorim të detyrës dhe funksionit publik, dhe pa asnjë akt zyrtar të shkruar, që të legjitimonte veprimtarinë e tyre.

1. Bashkia Tiranë ka kryer të gjitha veprimet pa asnjë njoftim zyrtar. Në ambientet e partisë Fryma e Re Demokratike, ishte ngjitur diku në korridoret e saj një letër, pa origjinë, pa nënshkrim titullari, pa vulë institucioni dhe pa numër protokolli, përveç një fjale "Ekstra", e datës 03.03.2021. Këtë njoftim e konsideronin si një akt zyrtar për të justifikuar veprimet e dhunshme dhe arbitrare që ishin planifikuar, me qëllim terrorizimin e kësaj force politike dhe të forcave opozitare në tërësi.

Përmes kësaj letre që **nuk plotëson asnjë element minimal të një akti administrativ, në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative (nenet 98-99 të Kodit të Procedurave Administrative)**, i kërkohej FRD-së: **"Lirimi i ambienteve për nevoja të Bashkisë Tiranë"**.

Kjo letër përveçse nuk plotësonte kriteret minimale të një akti të thjeshtë administrativ, **nuk citonte në përmbajtjen e saj, asnjë bazë ligjore, apo referencë se cila që arsyeja e vërtetë apo shkaku i ligjshëm, mbi të cilën mbështetej ky njoftim i paidentifikuar.**

2. Nga Bashkia Tiranë, në datë 12 mars 2021, selisë së Partisë Fryma e Re Demokratike, i është shkëputur njëkohësisht furnizimi me energji elektrike, ndërkohë që janë paraqitur punonjës të Policisë Bashkiake, të cilët kanë bllokuar hyrjen për në selinë e kësaj force politike, kur Kryetari dhe disa drejtues të tjerë të kësaj force politike ndodheshin të bllokuar brenda zyrave të saj. Këto veprime, qartazi synonin pamundësimin e veprimtarisë së kësaj

force politike opozitare, dhe nxjerrjen me forcë jashtë kësaj godine të Partisë së FRD-së, pa i mundësuar asaj një zgjidhje tjetër alternative.

3. I gjendur në këto kushte presioni dhe sulmi, Kryetari i FRD-së, ka njoftuar mediat, drejtuesit e partive politike, drejtuesin e KQZ-së, Kryeministrin, Kryetarin e Bashkisë Tiranë, përmes një deklarate urgjente për shtyp, si dhe Presidentin e Republikës.

4. Në cilësinë e Kryetarit të Shtetit, duke vënë re një tensionim që shkon deri në absurditet, për një vend demokratik e në prag të zgjedhjeve, kam ndjekur me vëmendje situatën e krijuar dhe kam vendosur për të kontaktuar jo vetëm drejtpërdrejt Kryetarin e FRD-së, por njëkohësisht edhe për të parë e verifikuar personalisht situatën e paprecedentë, që po ndodhte aty.

5. Kam vendosur të ndryshoj axhendën dhe të vizitoj selinë e kësaj force politike dhe pasi kam mbërritur në selinë e FRD-së, kam kontaktuar me drejtuesit e kësaj force politike dhe jam drejtuar për në zyrën e kësaj partie, për të biseduar me Kryetarin e saj dhe drejtuesit e tjerë të FRD-së, lidhur me këtë situatë të krijuar. Në momentin që jemi drejtuar për në hyrjen kryesore të godinës, dera ka qenë e mbyllur dhe e rrethuar me policë bashkiakë me uniformë dhe pa uniformë, sikur aty të ishte një skenë flagrante krimi, dhe jo të ishte hyrja për në selinë e një partie politike të ligjshme, e cila pak ditë më parë kishte nënshkruar një marrëveshje koalicioni me opozitën me opozitën e bashkuar.

6. Staf i shoqërues i Presidentit të Republikës, ka kërkuar që të hapet dera për të mundësuar hyrjen e Presidentit të Republikës dhe stafit që e shoqëronte, bashkë me drejtuesit e FRD-së.

7. Fillimisht është hapur dera dhe është lënë të hyjë vetëm Presidenti i Republikës, ndërkohë që ende pa u futur Presidenti në këtë godinë, stafi i Policisë Bashkiake i shoqëruar me disa shtetas të veshur civilë e që pretendonin se ishin funksionarë publikë, në mënyrë të dhunshme, pa akt zyrtar, pa dhënë asnjë shpjegim se cila qe mbështetja shkresore e veprimtarisë së tyre, kanë penguar me forcë e dhunë fizike, stafin që shoqëronte Presidentin e Republikës, përfshirë edhe disa nga drejtuesit e FRD-së.

8. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, si Kreu i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit, ka rolin e arbitrit, të moderatorit të pushteteve e të rregullatorit, si një figurë neutrale, me një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, në balancimin e pushteteve, si dhe në kryerjen e funksioneve të tyre respektive. Presidenti i Republikës mbart njëkohësisht përgjegjësinë të kujdeset për mbrojtjen e sistemit normativ, garantimin e parimeve shtetëformuese, si shteti i së drejtës, demokracia, pluralizmi politik, barazia sociale, dinjiteti njerëzor dhe respektimin të drejtave dhe lirive themelore. Me këtë përgjegjësi, Presidenti i Republikës, vendosi të vizitojë dhe bashkëbisedojë me Kryetarin e FRD-së, për t'u njohur prej tij, mbi atë që po ndodhte, duke shërbyer njëkohësisht si mundësi

që Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe administrata e tij, të ndërpriste veprimet e paligjshme dhe të merrte kohën e nevojshme për reflektim.

9. Por përkundrejt këtij detyrimi, që do të duhej të përmbushej nga strukturat vendore, në prezencë të Presidentit të Republikës, përmes veprimeve të tyre, punonjësit e Policisë Bashkiake, përveçse po pengonin ushtrimin normal të aktivitetit dhe përgjegjësi të Presidentit të Republikës, duke reflektuar dhunë e konflikt fizik me të pranishmit, po tregonin qartë se e gjithë veprimtaria e tyre, aty nuk po ushtrohej sipas ligjit, por nën frymën e militantizmit politik dhe urdhrave që kishin marrë. Ato veprime ishin reflektim i synimit për të përcjellë në publik mesazhin se, në këtë fushatë zgjedhore, çdo forcë politike që është kundra tyre (mazhorancës socialiste) do të sulmohet dhe për këtë nuk i ndal asnjë institucion, dhe as Presidenti i Republikës. E njëjta frymë u shfaq dhe dy ditë më vonë në qytetin e Elbasanit, ku eksponentë të krimit në këtë qytet, shoqëronin vizitën e Kryeministrit dhe të frymëzuar nga qëndrimi i tij përkundrejt disa mbështetësve opozitarë, në prani edhe të Policisë së Shtetit, kanë ushtruar dhunë ndaj qytetarëve. Kjo frymë represive që po përcjell mazhoranca ndaj bindjes së lirë të qytetarëve, është e papranueshme për çdo shoqëri demokratike.

10. Duke konstatuar këtë situatë, ekstremisht antikushtetuese dhe antiligjore, si Kryetar i Shtetit, kam reaguar menjëherë ndaj punonjësve të Policisë Bashkiake, për t'u larguar nga ky konflikt, që sa vinte dhe po shtoej, përmes veprimeve nxitëse të funksionarëve të Bashkisë Tiranë, të cilët përveçse po pengonin Presidentin e Republikës të ushtronte funksionet, përgjegjësitë dhe rolin e tij Kushtetues, nga ana tjetër, po jepnin shembullin më të keq të funksionimit të institucioneve sipas urdhërimeve politike dhe jashtë shtratit të ligjit.

11. Ndërkohë që, vetëm pasi ngjarja u bë publike, pas ndërhyrjes sime si Kreu i Shtetit, në adresë të FRD-së është dërguar një shkresë e Policisë Bashkiake, edhe kjo e korrigjuar, për lirim të menjëhershëm të selisë së FRD-së. Edhe kjo shkresë jo vetëm që ishte e pa referuar në asnjë akt ligjor, por pa asnjë mbështetje në kuadrin ligjor dhe faktet, përmend se ***“FRD ka zaptuar ambientet e Bashkisë Tiranë”***.

12. Ky është një tjetër falsifikim i Bashkisë së Tiranës, pasi Fryma e Re Demokratike, **as nuk është futur me forcë dhe as nuk ka zaptuar ndonjë ambjent apo zyrë publike. Qëndrimi i kësaj force politike në ambjentet pronë e Bashkisë Tiranë, ishte realizuar përmes një akti të ligjshëm siç është Kontrata e Huapërdorjes me Bashkinë Tiranë, dhe që në kuptim të ligjit, nuk mund të konsiderohet kurrësi “zaptim” i pronës shtetërore.**

13. Partia Fryma e Re Demokratike ndodhet në këtë seli që prej datës 23.03.2016, mbi bazën e një Marrëveshjeje të lidhur me Bashkinë Tiranë me Nr. 5216/2 prot. dhe Nr. 03/1 prot., datë 23.03.2016 “Kontratë Huapërdorje”, përmes të cilës në bazë të ligjit nr. 8580, datë 17.12.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, Bashkia Tiranë ka marrë përsipër përmbushjen e detyrimit

ligjor për të pajisur Frymën e Re Demokratike me Selinë Qëndrore dhe Zyrat Vendore, sipas ligjit.

14. Pra Fryma e Re Demokratike, ka ushtruar dhe vijon të ushtrrojë aktivitetin e saj publik dhe politik, që prej datës 23 mars 2016 në këtë seli, **pra prej 5 vitesh**, përmes një marrëveshjeje ligjore dhe nuk ka zaptuar asnjë centimetër pronë publike, siç pretendonte akti i paligjshëm i Bashkisë Tiranë i datës 12 mars 2021.

15. Në këtë marrëveshje ligjore të lidhur midis partisë Fryma e Re Demokratike dhe Bashkisë Tiranë, e cila është firmosur nga vet Kryetari i Bashkisë Tiranë, z.Erion Veliaj, në nenin 7 të saj citohet shprehimisht se:

“Neni 7

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeje

Palët bien dakord që të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate, të zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre, do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.”

16. Ndërkohë që neni 8, i kësaj Marrëveshjeje, i siguron një mbrojtje të posaçme FRD-së, por edhe Bashkisë Tiranë, pasi në pikën 1, të këtij neni, parashikohet shprehimisht se: **“Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil dhe Legjislacionit në fuqi”**. Pra vetë marrëveshja, referon në zbatimin e parashikimeve të Kodit Civil dhe ligjit nr.8580, datë 17.12.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

17. Referuar këtyre akteve të nënshkuara midis palëve dhe zbatimit të ligjeve të përmenduar në vet marrëveshjen e lidhur, Bashkia Tiranë, nuk ka asnjë autoritet ta zgjidhë me vetgjyqësi këtë çështje, por nëse do ta konsideronte këtë një mosmarrëveshje, ajo, pra Bashkia Tiranë, duhet t’i drejtohej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, siç kanë rënë vet dakord me marrëveshje. **Dhe ky hap do të duhej të ndërmerrej vetëm pasi të ishin konsumuar dhe shteruar me drejtuesit e kësaj Partie të gjitha mundësitë e zgjidhjes me bisedime dhe mirëkuptim.**

18. Çdo veprim tjetër i kryer, për urdhërimin e lirit të ambienteve, është i paligjshëm, antikushtetues dhe përmban elementë të veprës penale, të shpërdorimit të detyrës dhe zgjidhjes së konflikteve përmes vetgjyqësisë.

19. E theksoj se gjithçka ka ndodhur me Partinë Fryma e re Demokratike, është planifikuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, pasi FRD zgjodhi të ishte aleate opozitare në zgjedhjet e 25 prillit 2021. Kjo vërtetohet edhe përmes statusit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, në rrjetin social *Twitter*¹, në datën 15 mars 2021, ku ai citon: *“Kontrata e 2016-ës mes Bashkisë Tiranë*

¹ <https://twitter.com/erionveliaj/status/1371441748199800833?s=24>

dhe partise qe Salii² i rrembeu ish-Presidentit ka qene per VETEM I VIT! Ka 4 vite qe ndertesa zaptohet pa kontrate. Keto jane faktet. Lironi ndertesen publike, po keni pak dinjitet!"

20. Nga ky qëndrim publik, por dhe referuar deklaratave të tij për mediat si në rrugë telefonike apo përmes ekranit, është e qartë dhe e provuar se, vetëm pasi FRD zgjodhi të ishte në koalicion opozitar në zgjedhjet e 25 prillit, ajo sipas Qeverisë dhe Bashkisë Tiranë, humbet edhe të drejtën që ia nje ligji për t'u pajisur me zyra. Ajo që duhet theksuar është fakti se, në asnjë prej njoftimeve shkresore, nuk evidentohet shkaku se përse FRD-së i ka humbur e drejta për të patur zyrë, apo për të qëndruar në ato ambiente. Pikërisht ky fakt, tregon edhe një herë se çdo veprim ka orientim politik dhe aspak ligjor.

21. Vetëm pas presionit të madh publik dhe mediatik, Bashkia Tiranë, në datë 13 mars 2021, i ka dorëzuar në mënyrë zyrtare FRD-së një shkresë formale të nënshkruar dhe vulosur me protokoll të rregullt, nga autoritetet e Bashkisë (Nr.916/2 prot, datë 12.03.2021). Kjo shkresë i referohet një Urdhri të nxjerrë në orët e vona të natës të datës 12 mars nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Përmes kësaj shkrese kërkohet "lirimi i ambjenteve", brenda 10-ditëve, por çuditërisht të dy këto akte, si Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë, ashtu dhe njoftimi i zyrtarëve të kësaj Bashkie drejtuar FRD-së, nuk i referohen as kushteve të Marrëveshjes që ka Bashkia me FRD-në, që prej shkurtit 2016 dhe as ligjit nr.8580, datë 17.12.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar.

22. Kjo ngjarje, që ngjan sa e pabesueshme, aq edhe absurde, ka ndodhur vërtet. Ka ndodhur vërtet që një institucionin shtetëror, Bashkia Tiranë në këtë rast, të çojë copa letrash pa vulë dhe firmë, e t'i konsiderojë si njoftime zyrtare. Kur kjo ndodh me një parti politike që është pjesë e opozitës dhe shumë afër zgjedhjeve, mënyra se si trajtohen qytetarët e thjeshtë, është edhe më shqetësuese.

23. E gjithë veprimtaria e Kryetarit të Bashkisë:

- është në shkelje të hapur të të gjitha parimeve mbi të cilat ushtron veprimtarinë e saj administrata shtetërore;
- cenon hapur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, dhe
- minon frymën demokratike dhe të barazisë para ligjit, që duhet të karakterizojë, periudhën para dhe gjatë zgjedhore, për të gjitha subjektet;
- është hakmarrëse dhe frikësuese.

Kjo sjellje është e papranueshme për një vend demokratik, që duhet të përmbushë kushtin kryesor të vendosur nga Bashkimi Evropian, për zgjedhje të lira e të ndershme.

² I referohet zoti Sali Shehu.

Në funksion të realizimit të një procesi zgjedhor të qetë dhe sipas standarteve europiane; për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese; dhe për të frenuar e denoncuar çdo fenomen negativ që mund të shfaqet, Presidenti i Republikës përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore, e në vijim, do të ketë vëmendjen maksimale, për të monitoruar të gjithë veprimtarinë shtetërore, dhe situatën zgjedhore në tërësi, për të evidentuar apo frenuar çdo veprim apo mosveprim të kundraligjshëm që reflekton apo është shprehje e hapur e përpjekjeve për të ushtruar trysni politike, apo që synon të cenojë votën e lirë të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, sepse vetëm zgjedhjet e lira dhe të ndershme do t'i japin fund krizës së legjitimitetit dhe të përfaqësimit, si dhe do të zhblokonin çeljen e negociatave me Bashkimin Europian.

Bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të cituar më sipër.

Sinqerisht,
Ilir Meta

The image shows the official seal of the President of the Republic of Albania, which is circular and contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top and "PRESIDENTI" at the bottom. Overlaid on the seal is a handwritten signature in blue ink.